



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.138/11

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësve B. E., Gj. E., R. E. dhe A. S. – E., që të gjithë nga fshati Piranë komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. E. G. nga Prizreni, kundër të paditues Korporata Energjetike e Kosoves (KEK) me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga i autorizuari i saj Z. Sh. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 70.000 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 13.03.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve B. E., Gj. E., R. E. dhe A. S. – E., që të gjithë nga fshati Piranë komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av. E. G. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që “të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë që në emër të dëmit të shkaktuar më kontakt të shkurtër në rrjetin elektrik me tension të ulët në fshatin P., për shkak të djegies së objektit në tërësi dhe të sendeve të djegura të specifikuar në ekspertizë, paditësve t’ia paguaj në shumën prej 70.000 (shtatëdhjetmijë) euro, me kamatë bankare duke filluar nga data 24.02.2011, e deri në pagimin e dënimit të borgjit, si dhe që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj paditësve shumën në lartësi prej 500 euro, të gjitha këto brenda afatit 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”, si **tërësisht e pabazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, përmes të cilës kanë theksuar se ata kanë poseduar një objekt (ndihmës) banimi për vendosjen e makinerisë bujqësore, ahurin për bagëti dhe deponinë e ushqimit për bagëti. Ndërtesa ka qënë e ndërtuar me material të fortë ndërtimor, me gjatësi 30 metra dhe gjerësi 7 metra. Në këtë objekt, me datën 28.07.2009, rreth orës 13.45 minuta, ka shpërthyer zjarri i cili ishte përhapur në tërë ndërtesën, për shkak të kontaktit të shkurtër të rrymës elektrike, me ç’rast nga zjarri janë djegur të gjitha makineritë bujqësore të cilat kanë qënë aty, teknika e bardhë, ushqimi i bagëtive, një lopë si dhe të gjitha sendet e tjera të cilat janë gjendur aty, në vlerë të përafërt prej 70.000 euro. Deri te zjarri kishte ardhur për shkak të lidhjes së shkurtër në instalimin elektrik i cili bënte furnizimin me energji elektrike. Sipas padisë, e paditura është e obliguar që të siguroj energji elektrike me forcë prej 220 V dhe në këtë mënyrë t’i eliminoj mundësitë

e shkaktit të kontaktit të shkurtër i cili gjithmonë është shkaktarë i zjarreve nga rryma elektrike, andaj në këtë rast përgjegjësia i takon asaj.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. E. G. nga Prizreni, kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë padisë dhe kërkespadi së tyre. Në fjalën e tij të fundit, i autorizuari i paditësve av. E. G. nga Prizreni ka shtuar se nga provat e administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në bazë të konstatimit dhe mendimit të ekspertit të elektroteknikës M. Gj. nga Prizreni, del se deri te djegia ka ardhur për shkak të luhajtjeve të tensionit elektrik nga rrjeti furnizues, respektivisht për shkak të ramjeve të tensionit dhe ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike, ku për pasojë edhe ka ardhur deri te nxemja e motorëve në aparaturën elektrike të paditësve, me ç'rast atyre u është djegur pasurija e cila është objekt i këtij kontesti. Mbi bazën e të lartëcekurave gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar dhe ta obligoj të paditurën që në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të kontaktit të shkurt në rrjetin elektrik, t'ia paguaj paditësve shumën në lartësi prej 70.000 euro, me kamat ligjore të llogaritur nga data 24.02.2011, e deri në pagesën definitive. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 500 eurove, të cilat i ka specifikuar sikurse në fjalën e tij të fundit para gjykatës.

E paditura KEK, përmes përgjigjës me shkrim në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, si nga baza ashtu edhe nga lartësija. Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i të paditurës Z. Sh. nga Prishtina, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjës me shkrim ndaj padisë, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka shtuar se paditësve u mungon baza juridike e kërkesëpadi së për të kërkuar shpërblimin e dëmit material për djegien e objektit të ndihmës (kuzhinës verore), i cili ka ndodhur me 28.07.2009, rreth orës 13,52 minuta, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditësve për rastin e ndodhur. Sipas tij, zjari i cili ka shpërthyer në objektin ndihmës të paditësve, nuk është pasojë e luhajtjeve të tensionit nga rrjeti i të paditurës, por nga lëshimet e vet paditësve dhe atë për shkak të parregullësisë së instalimit të brendshëm, ku si pasojë edhe ka ardhur deri te lidhja e shkurt në instalimin elektrik që bënë furnizimin me energji elektrike. Kjo gjendje është vërtetuar me procesverbalin mbi verifikimin dhe hulumtimin e rastit, të datës 28.07.2009, i përpiluar nga DKMSH - Sektori parandalimit ndaj zjarrit në Prizren, i cili është përpiluar në vendin e ngjarjes nga ekipi prej 3 zyrtarëve të shërbimit të lartëcekur, ku theksohet se që nga kabloja elektrike që vinte nga objekti dhe i tërë instalimi në vazhdim, është bërë në kundërshtim me rregullat teknike dhe shfaqja zjarrit në objektin ndihmës është pasojë e lidhjes së shkurtër në instalimin e objektit që bënte furnizimin e pajisjeve elektrike (frizat) si dhe nga parregullsia e instalimeve të tjera elektrike ose ngarkesës së tepërt nga këto instalime elektrike. Gjithashtu nga raporti i vendit të ngjarjes të Stacionit Policor "Alfa" në Prizren - njësi i Hetuesisë, është përshkruar e tërë ngjarja ku nga fotot e bëra me atë rast mund të shikohet se instalimi elektrik nuk ka qenë sipas rregullave teknike dhe sasia e pajisjeve të cilat i ka poseduar paditësi në atë pjesë të objektit, ka qenë në disharmoni me instalimin elektrik. Më tej ka shtuar se edhe eksperti i elektroteknikës i caktuar nga gjykata, në ekspertizën e tij dhe skjarimet shpesh të bëra në seancën e datës 06.02.2013, ka theksuar se në ditën kur ka vizituar shtëpinë e paditësit në fshatin P., objekti ku ka ndodhur paraqitja e zjarrit nuk ka egzistuar, respektivisht vendi ka qenë tërësisht i pastruar. Prandaj nga kjo mund të konkludohet se eksperti nuk ka pasur mundësi të vërtetetoj shkaktarin e zjarrit të këtij rasti, për shkak të humbjes së gjurmëve, ndërsa që mendimin e vet e ka dhënë vetëm në bazë të supozimeve, e me supozime nuk mund të krijohet baza e kërkesëpadi së. Shpërthimi i zjarrit ka ndodhur në objektin ndihmës i cili nuk ka pasur njuhësor elektrik, ku furnizimi me energji elektrike për atë objekt është bërë me kablo vazhduese nga priza e vendosur në objektin ku ka pasur njuhësor elektrik, metodë kjo e palejshme me standarde teknike, sepse është e njohur se kapaciteti i një prize

nuk mund ta bartë hargjimin e energjisë elektrike për të gjithë hargjuesit e instaluar në objektin ndihmës. Është krejt normale që në këtë rast paditësi e ka mbingarkuar hargjimin dhe për shkak të kësaj kablloja vazhduese por edhe priza, nuk e ka duruar këtë ngarkesë, d.m.th kapaciteti i kabllos vazhduese dhe priza nga është furnizuar kjo kablo, ka pasur kapacitet më të vogël - më të ulët se sa ngarkesa dhe se në këto kushte është normale që të paraqitet lidhja e shkurtër për shkak të mbi ngarkesës. Se furnizimi në këtë mënyrë është teknikisht dhe ligjërisht i pa lejuar, e ka konstatuar edhe eksperti gjyqësor duke theksuar se kualiteti i kabllos vazhduese nuk i ka plotësuar standardet teknike. E paditura i'a ka dhënë paditësve pëlqimin elektroenergjetik për objektin ku e ka pasur të instaluar njehësorin me kapacitet të hargjuesve që e ka pasur objekti, kurse për ta shtuar kapacitetin e shpenzimit të energjisë elektrike, paditësi është dashur që t'i drejtohet të paditurës për pëlqim të ri elektroenergjetik për kapacitetin e rritur, në të kundërtën çdo veprim në kundërshtim me pëlqimin e lëshuar nga e paditura, bie në barrën e vet paditësve. Sa i përket ekspertizës, i autorizuari i të paditurës ka shkjaruar se kjo ekspertizë në mënyrë të qart ka definuar se rasti ka ndodhur në zonën e përgjegjësive së paditësve për shkak të parregullësive teknike në instalimin e objektit shtesë si dhe kabllos vazhduese e cila nuk i ka plotësuar kushtet teknike për shkak të materialit të dobët të saj. Pohimet e ekspertit se ka pasur luhatje në tension dhe ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike, janë të pa bazuar me prova materiale, sepse ndërprerje ka patur shumë rallë ndërsa luhatje nuk ka pasur fare, çka dëshmohet edhe me faktin se asnjë objekt tjetër përpos objektit ndihmës të paditësve, nuk ka pësuar dëm dhe se dijagrami i regjistrimit të tensionit në trafon e të paditurës, tregon se luhatjet në tension nuk kanë egzistuar dhe se furnizimi me energji elektrike është bërë me rregull dhe pa probleme. Sipas tij, e paditura tani më e ka të njohur slloganin e ekspertëve për luhatjen e tensionit, mbtensionin apo ndërprerjen e energjisë elektrike, që ndoshta kanë patur kuptim për periudhën menjëherë pas luftës kur edhe realisht ka patur probleme në rrjet, kurse në kohën kur ka ndodhur rasti, janë të papranushme slloganët e tillë, pasi që furnizimi me rrymë bëhet me rregull dhe pa probleme, me përjashtim me rasteve kur ndikon fuqija madhore, kushtet atmosferike etj. Mbi bazën e të lartëcekurave dhe meqenëse përgjegjësija për rastin e ndodhur është subjektive dhe e vet paditësve, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërsi si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Shpëtimit e Komunës së Prizrenit me nr. 24/09, i datës 03.08.2009; procesverbali mbi verifikimin dhe hulumtimin e rastit të datës 28.07.2009, i lëshuar nga DKMSH - Sektori i parandalimit nga zjarri, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, i Komunës së Prizrenit; raporti policor i vendit të ngjarjës me nr. 2009-GA-1943, të datës 28.07.2009, i Drejtorisë Rajonale të Policisë - Stacionit Policor "Alfa" në Prizren - njësi i hetuesisë – sektori i krimë teknikës dhe forenzikës, bashkë me fotot përcjellëse si dhe skicën e vendit të ngjarjës; aktvdekja për të ndjerin A. E. me nr. 200-182, e datës 20.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikata e lindjes për paditësen Gj. E. me numër rendor 40, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikata e lindjes për paditësin R. E. me numër rendor 46, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikata e lindjes për paditësen A. E. me numër rendor 1, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikata e lindjes për paditësin B. E. me numër rendor 37, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; transaksioni i konsumatorit me nr.38728; fatura e tatimit në pronë e datës 05.04.2012; dëftesa me nr. 014105, e datës 10.11.2011, e lëshuar nga "I. C."; fatura tatimore me nr.2049572005, për vitin tatimor 2005, bashkë me fletëpagesën e "R. B.", e datës 19.10.2005; fatura tatimore për vitin tatimor 2008 me nr.3268738, bashkë me faturën e pagesës të "N. B." Prishtina, e datës 27.02.2009; fatura tatimore për vitin tatimor 2008 me nr.3303908, bashkë me fletëpagesën e "N. B." Prishtinë,

e datës 27.02.2009; çertifikata e vdekjes për të ndjerin A. E. me numër rendor 402, e datës 02.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit, si dhe ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës të angazhuar në këtë çështje kontestimore, M. Gj., e datës 17.09.2012.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar.

Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Shpëtimit e Komunës së Prizrenit me nr. 24/09, i datës 03.08.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 28.07.2009, rreth orës 13.45 minuta, në objektet e banimit të këtu paditësve, përkatësisht në objektin ndihmës afër objektit të banimit, kishte ardhur deri te shperthimi i zjarrit. Në këtë zjarr kishte pësuar një kafshë, traktori, automjeti, motokultivatori, shtalla në tërësi, si dhe mobileritë në brendësi të objektit, më saktësisht sikurse në këtë vërtetim. Fakti i shpërthimit të zjarrit është vërtetuar edhe përmes procesverbalit mbi verifikimin dhe hulumtimin e rastit të datës 28.07.2009, i lëshuar nga DKMSh - Sektori i parandalimit nga zjarri, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, i Komunës së Prizrenit, si dhe raportit policor të vendit të ngjarjes me nr.2009-GA-1943, të datës 28.07.2009, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë - Stacionit Policor “Alfa” në Prizren - njësi i hetuesisë – sektori i krimë teknikës dhe forenzikës, bashkë me fotot përcjellëse si dhe skicën e vendit të ngjarjes.

Në bazë të aktvdekjes për të ndjerin A. E. me nr. 200-182, e datës 20.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikatës së lindjes për paditësen Gj. E. me numër rendor 40, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikatës së lindjes për paditësin R. E. me numër rendor 46, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikatës së lindjes për paditësen A. E. me numër rendor 1, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit; çertifikatës së lindjes për paditësin B. E. me numër rendor 37, e datës 18.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit, si dhe çertifikatës së vdekjes për të ndjerin A. E. me numër rendor 402, e datës 02.04.2012, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit, gjykata e ka vërtetuar legjitimacionin aktiv të këtu paditësve.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit të elektroteknikës të angazhuar në këtë çështje kontestimore, M. Gj., të datës 17.09.2012, gjykata ka konstatuar se objekti ku kishte ardhur deri te paraqitja e zjarrit është objekti në oborrin e shtëpisë në anën e djathtë nga hyrja kryesore e shtëpisë së banimit. Objekti ku ka ndodhur djegia, tani është tërësisht i pastruar sikurse në fotot përcjellëse të kësaj ekspertize. Sipas raportit të sektorit të preventivës dhe hulumtimit ndaj zjarrit në Prizren, është konstatuar se zjarri ishte shkaktuar nga kontakti i shkurtë-lidhës në instalimin elektrikë që bënte furnizimin me energji elektrike për pajisjet elektrike - frizat si dhe parregullsive të instalimeve të tjera elektrike ose ngarkesave të tepërta në këto instalime. Pajisjet elektrike – frizat, në kuadër të insatlimit të tyre kanë edhe kompresoret për ftohje e që funksionojnë me motorr elektrik. Motoret e kompresorëve për ftohje posedojnë sistemin mbrojtës në kuadër të kompresorit. Motori i kompresorit të pajisjeve për ftohje, është i ndieshëm në furnizimin me tension elektrik, ku për shkak të tensionit të ulët sistemi i funksionimit normal ndryshon, motori fillon të nxehet dhe ngarkohet më shumë se zakonisht. Në rastet kur zvogëlohet ose bije tensioni i furnizimit me energji elektrike, motori nuk është në gjendje me e vu në funksion kompresorin dhe për këtë vije edhe deri te frenimi i motorit, e që si pasojë e frenimit dhe nxemjes motori mund të digjet si dhe jep edhe lidhje të shkurtër. Instalimi i mbidimensionuar, pamundësia e reagimit të sistemit të siguresave, shkakton paraqitjen e zjarrit tek përquesit. Njihësori elektrik i

vendosur në objektin e banimit është prodhim “Iskra” ne numër 32780820, i tipit 31 cdv-s, viti i prodhimit 2002, i bllobuar nga ana e KEK-ut dhe në gjendje të rregullt. Sipas këtij raporti – ekspertize, në gjendjen në të cilën gjendet objekti i djegur, është vështirë që të jipet mendim në lidhje me shkaktarin e zjarrit edhe pse luhajtet e tensionit elektrik, distanca e madhe e rjetit furnizues, rramjet e tensionit elektrik, ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike, instalimet me parregullësira të mëdha, kualiteti i pajisjeve elektrike për kyqje të vazhduesve të ndryshëm, janë shkaktarë të paraqitjes së prishjeve në aparatura elektrike. Eksperti i lartëcekur, po ashtu në seancë ka shkjaruar se në ditën kur e ka vizituar shtëpinë e paditësve, në fshatin P. komuna e Prizrenit, objekti ku kishte shpërthyer zjarri, nuk ka ekzistuar, respektivisht ai vend ka qenë tërësisht i pastruar. Sipas tij, bazuar në raportin e sektorit të preventivës dhe hulumtimit të Komunës së Prizrenit, në kohën kur është paraqitur zjarri në objekt, pas vizitës së bërë nga ana e tyre, është përpiluar procesverbal i cili gjendet në shkresat e lëndës, e në të cilin procesverbal konstatohet se paraqitja e zjarrit ka ardhur si pasojë e kontaktit të shkurtër-lidhës në instalimin elektrik, i cili ka bërë furnizimin me energji elektrike për pajisjet – frizat që kanë qenë në atë objekt. Duke e analizuar këtë raport dhe duke e ditur punën e pajisjeve elektrike (frizat), e që në kuadër të tyre ekzistojnë motorët elektrikë, me luhajtjen e tensionit vjen deri te zvogëlimi i fuqisë së motorit, me ç’rast motori fillon të tërheq rrymë më tepër, apo tenton që të largojë rrymën e tepërt. Po ashtu në raportin se sektorit të preventivës nga zjarri në Komunën e Prizrenit, si shkaktar është përmendur edhe parregullësia e instalimit elektrik. Duke e ditur se në këto objekte ndihmëse furnizimi i pajisjeve kryehet edhe me kablllo vazhduese, e duke ditur se në tregun momental ekzistojnë kablllo të vazhdueshme të llojeve të ndryshme, në momentin kur motori i frizit ose i kompresorit të frizit fillon të tërheq rrymë më tepër, në pamundësi të reagimit të sistemit mbrojtës, kjo rrjedhje fillon të kërkoj pikët e dobëta të instalimit, ku në ato pika mund të vijë deri te nxemja e përqesit, respektivisht paraqitja e lidhjes së shkurtër e cila mund të reflektohet me paraqitjen e zjarrit. Më tutje eksperti M. Gj. ka shkjaruar se **edhe përkundër tensionit të ulët, nëse pajisjet e brendshme elektrike janë teknikisht të instaluara mirë dhe me normativa teknike, mund të vije deri te djegia e pajisjes, por jo edhe te djegia e instalimit.** Po ashtu edhe në rast se tensioni i rrymës është normal, ndërsa pajisja të mos ketë qenë në rregull, mund të ndodhë që për shkak të kësaj të vije deri te lidhje e shkurtër, e cila mund të shkaktoj zjarrin. Sipas tij, në rastin në fjalë, është kabllloja ajo e cila është djegur, e cila kablllo ka qenë brenda objektit, ndërsa kabllloja prej shtëpisë banuese të paditësve e deri tek objekti i cili është djegur (përkatësisht kabllloja e jashtëme), në të vërtetë edhe sot e kësaj dite është e padëmtuar. Përgjegjësia e KEK-ut është deri te njehsori elektrik, ndërsa instalimi i brendshëm elektrik i objektit është përgjegjësi e pronarit të objektit dhe organizimi i instalimit të rrymës elektrike në këto raste varet prej investimeve të pronarit përkatës.

Baza ligjore

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se **“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**.

Me nenin 5.5.3.2 pika (b) të Kodit të Shpërndarjes së energjisë elektrike të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, ndër të tjera, parashihet se **“në objektet afariste dhe të amvisërisë, përgjegjësia e OSSh-së, është deri në pikën e kyqjes në pjesën e pasme të njehsorit ose në anën e furnizimit të ndërprerësit kryesor (siguresave kryesore)”**.

Me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se **“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”**.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk është kontestues fakti i shpërthimit të zjarrit i cili kishte ndodhur në objektin ndihmës të paditësve me datën 28.07.2009, rreth orës 13.45 minuta. Kontestuese paraqitet të jetë shkaku i shpërthimit të zjarrit, përkatësisht fakti se a ka shpërthyer zjarri në zonën e përgjegjësisë së të paditurës, apo në zonën ku përgjegjësia kalon në konsumatorin, përkatësisht këtu paditësit. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjykata ka vlerësuar se kërkespadija e paditësve është e pabazuar edhe se e njëjta duhet refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar përgjegjësia e të paditurës në rastin në fjalë, përkatësisht nuk është vërtetuar se në ditën kritike zjarri ka shpërthyer në zonën e cila bie në përgjegjësinë e të paditurës. Deri te ky konstatim gjykata ka ardhur në bazë të provave të lartëadministruara, e sidomos në bazë të ekspertizës dhe skjarimeve shtesë të ekspertit të elektrotëknikës të angazhuar në këtë çështje kontestimore Myzhdat Gjini, të cilave gjykata ua fali besimin e plotë. Në të vërtetë në bazë të ekspertit Myzhdat Gjini, del se edhe përkundër tensionit të ulët, përkatësisht edhe në rastet e luhatjeve të tensionit, nëse pajisjet e brendshme elektrike janë teknikisht të instaluar mirë dhe me normativa teknike, mund të vije deri te djegia e pajisjes, **por jo edhe te djegia e instalimit**. Por edhe në rast se tensioni i rrymës është normal, ndërsa pajisja nuk është e montuar në rregull, mund të ndodhë që për shkak të kësaj të vije deri te lidhje e shkurtër, e cila mund të shkaktoj zjarrin. Me rastin e vendosjes gjykata e mori për bazë edhe faktin se në rastin në fjalë, është kabllorja e cila ka qenë brenda objektit ajo e cila është djegur, ndërsa kabllorja prej shtëpisë banuese të paditësve e deri tek objekti i cili është djegur, në të vërtetë edhe sot e kësaj dite është e padëmtuar. Andaj duke pasur parasysh faktin se përgjegjësia e të paditurës (KEK) është deri te njëhori elektrik, ndërsa instalimi i brendshëm elektrik i objektit është përgjegjësi e pronarit të objektit (siq edhe e parashohin dispozitat ligjore të lartëcituara), gjykata e refuzoi kërkespadijën e paditësve ngase gjeti se e njëjta është e pabazuar. Vlenë të theksohet se ekspertizën në fjalë si dhe skjarimet shtesë në seancë, të ekspertit M. Gj., nuk i kanë kundërshtuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse e as që kanë propozuar ndonjë ekspertizë tjetër eventuale.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.138/11, me datë 13.03.2013

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.